

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

# KRIZA ENERGETIKE

## KUNDREJT

# DEKARBONIZIMIT

# NË RMV



DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

# KRIZA ENERGETIKE

KUNDREJT

# DEKARBONIZIMIT

# NË RMV

## Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

## Projekti

"Organizatave civile në veprim për klimën"

## Implementues

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-vest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

## Titulli Original

ДОКУМЕНТ ЗА ЈАВНИ ПОЛИТИКИ ЕНЕРГЕТСКАТА КРИЗА НАСПРОТИ ДЕКАРБОНИЗАЦИЈАТА ВО РСМ

## Autor

Jasna Orovcane Arangjeloviq

## Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi

Rexhep Xheladini

## Dizajn grafik

Haris Muriq

Shkup, 2023



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Organizatave civile në veprim për klimën", mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

PËR DOKUMENTIN	1
HYRJE	2
VENDIM PËR GJENDJEN E KRIZËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE	2
LIGJI PËR ENERGJETIKË DHE LIGJI PËR EFIKASITETIN ENERGJETIKË	3
PRIORITETET STRATEGJIKE TË QEVERISË DHE PROGRAMI I PUNËS SË QEVERISË SË RMV-SË 2020-2024	4
STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E ENERGJETIKËS NË RMV DERI NË VITIN 2040 DHE PLANI NACIONAL PËR ENERGJINË DHE KLIMËN I RMV-SË	6
PROGRAMI PËR ZBATIM TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË ENERGJETIKËS 2021-2025	8
PLANI PËR TEJKALIMIN E KRIZËS ENERGJETIKE TË QEVERISË SË RMV-SË	10
KONKLUZIONE	11

# PËRMBAJTJA

# LISTA E SHKURTESAVE

<b>RMV</b>	_____	Republika e Maqedonisë së Veriut
<b>HEC</b>	_____	Hydrocentralet
<b>TEC</b>	_____	Termocentralet
<b>BRE</b>	_____	Burimet e ripërtëritshme të energjisë
<b>EE</b>	_____	Efikasiteti energjetikë
<b>EC</b>	_____	Elektro-centralet
<b>ESM</b>	_____	Centralet e energjisë të Maqedonisë së Veriut

# PËR DOKUMENTIN

Ky dokument është përpiluar në kuadër të projektit "Organizatet civile në veprim për ndryshimet klimatike", i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar si donatore dhe i implementuar nga Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-svest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizatës lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP.

Ky dokument do të japë një pasqyrë të shkurtër të krizës energjetike nga fillimi i vitit 2022 me të cilën po përballet Republika e Maqedonisë së Veriut dhe të synimeve, planeve dhe strategjive ekzistuese për zhvillimin e energjetikës në drejtim të tendencave energjetike për kalimin në ekonominë me karbon të ulët, ku burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe efikasiteti energjetikë janë ndër faktorët më të rëndësishëm që mundësojnë tranzicionin . Dokumenti do të prezantojë disa nga vendimet e Qeverisë së RMV-së në lidhje me krizën energjetike, përmbledhje të shkurtër të ligjeve aktuale në fushën e energjetikës, detyrimet e marra, Programi i Punës së Qeverisë së RMV-së 2020-2024, në pjesën e energjetikës, Strategjia për zhvillimin e energjetikës në RMV-ë deri në vitin 2040 dhe Plani Nacional për Energjinë dhe Klimën i RMV-së nga viti 2020. Dokumenti do të japë një pasqyrë të shkurtër të Programit për zbatim të strategjisë së zhvillimit të energjetikës 2021-2025, i cili është përgatitur por nuk është miratuar.

Qëllimi i dokumentit është që përmes paraqitjes së vendimeve dhe dokumenteve të caktuara të vërë në dukje dhe të shtrojë pyetjen nëse detyrimet dhe angazhimet e marra të shtetit për kalimin në një ekonomi me karbon të ulët janë të mundshme dhe të realizueshme, gjegjësisht nëse mund të bëhen realitet apo do të mbeten fjalë e vdekur në letër.

Realizimi i politikave dhe masave të parapara, si dhe zbatimi i ligjeve në fushën e energjetikës, ka një ndikim të rëndësishëm në klimën dhe mjedisin jetësor. Nga dokumenti do të dalin konkluzione të caktuara që mund të ndikojnë në përmirësimin e politikave të caktuara për zbatimin konsekuent të detyrimeve të ndërmarra nga palët përkatëse të interesit.

Dokumenti është përgatitur duke përdorur veglën e hulumtimit në zyrë.

# HYRJE

Tendencat globale energjetike sjellin në plan të parë ndryshimin e klimës dhe mungesën e burimeve. Paralelisht me rritjen e nevojave globale për energji të përbalueshme dhe të besueshme, bota po shkon drejt përdorimit më të madh të energjisë me karbon të ulët. Si një burim energjie më i pastër dhe më i qëndrueshëm, gazi natyror po zëvendëson qymyrin dhe në të njëjtën kohë, energjia e ripërtëritshme po tregon rritje të shpejtë si pjesë e transformimit të energjisë në botë. Përdorimi efikas i energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme janë baza e tranzicionit energjetik. Lëndët djegëse pa karbon pritet të luajnë një rol shumë më të madh në konsumin e ardhshëm të energjisë primare, me burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) që shohin rritjen më të madhe. Skenari i politikave aktuale projekton tendencat e ardhshme bazuar në legjislacionin ekzistues duke supozuar se nuk ka ndryshime të rëndësishme në politikat globale për burimet e ripërtëritshme të energjisë, ndryshimet klimatike, lëndët djegëse fosile, investimet në teknologji, etj. Maqedonia e Veriut duhet të ndjekë tendencat dhe për këtë shteti është i obliguar që t'i përshtat politikat dhe masat e veta, si dhe të harmonizojë rregulloren ekzistuese si pikënisje për realizimin e transformimit energjetik.

## VENDIMI PËR GJENDJEN E KRIZËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

Në muajin nëntor të vitit 2021, Qeveria e RMV-së miratoi Vendim për ekzistimin e gjendjes së krizës në furnizimin me energji elektrike, me të cilin konstatohet ekzistimi i gjendjes së krizës në të gjithë territorin e RMV-së/shtet.<sup>1</sup> Sipas vendimit, do të ndërmerren masa dhe aktivitete në lidhje me sigurimin e sasive shtesë të energjisë elektrike, përfshirë energjinë e bilancit dhe rezervën e fuqisë aktive në përputhje me Ligjin për Energjetik dhe Dekreti për kriteret dhe kushtet për shpalljen e gjendjes së krizës në rastet e motit dhe fatkeqësive natyrore, avarive dhe shqetësimeve në tregjet e energjisë elektrike, mënyrën e furnizimit me energji elektrike në gjendje krize, masat e marra në rast krize, si dhe të drejtat dhe detyrimet e mbajtësve të licencave për kryerjen e veprimtarive të energjisë elektrike.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> <https://vlada.mk/node/26960>, „Службен весник“ на РСМ бр. 252/21 од 10.11.2021 година

<sup>2</sup> <https://akademik.mk/celosen-tekst-na-donesenata-uredba-za-proglasuvane-krizna-sostojba-vo-snabduvaneto-so-elektichna-energija/>

Sipas Dekretit, ekzistojnë disa kushte për shpalljen e gjendjes së krizës, ndër të cilat: mungesa e energjisë elektrike në tregun e brendshëm, si dhe në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të energjisë elektrike dhe një rritje e paparashikuar e ndjeshme e çmimit të energjisë elektrike për një periudhë të caktuar kohore.

Qeveria e RMV-së në muajin gusht të vitit 2022, ka marrë vendime lidhur me ekzistimin e gjendjes së krizës në furnizimin me energji termike në zonën e qytetit të Shkupit dhe në furnizimin me energji elektrike në tërë territorin e Republikës Maqedonisë së Veriut. Njëri vendim është marrë për shkak të mungesës së energjisë termike, mundësisë së përdorimit të lëndëve djegëse alternative dhe gjendjes së tregut të energjisë termike. Vendimi tjetër është marrë për shkak të mungesës së energjisë elektrike dhe gjendjes së tregjeve të energjisë elektrike.<sup>3</sup>

## LIGJI PËR ENERGJETIKË DHE LIGJI PËR EFIKASITET ENERGJETIKË

Maqedonia e Veriut nënshkroi Marrëveshjen për themelimin e Komunitetit Energjetikë dhe si rrjedhojë ka ndërmarrë një numër të madh të obligimeve, të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e legjislacionit kombëtar në fushën e energjetikës dhe mjedisit jetësor me legjislacionin e BE-së.

Në fushën e energjetikës, ligjet qeverisëse janë Ligji për Energjetikë dhe Ligji për Efkasitet Energjetikë. Me Ligjin për Energjetikë dhe me ndryshimet e miratuara në vitin 2022, Direktivat dhe Rregulloret janë transpozuar në përputhje me Vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjetikë nr. D/2011/02/MC-EnC. Ndër objektivat themelore të ligjit janë:

- › furnizimi i besueshëm, i sigurt dhe cilësor i konsumatorëve me energji në përputhje me përcaktimet strategjike në fushën e energjetikës;
- › nxitja e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme përmes masave të përshtatshme dhe efektive financiare dhe të tjera mbështetëse, me qëllim arritjen e qëllimeve të politikës për burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe garantimin e sigurisë së furnizimit me energji;
- › mbrojtja e mjedisit jetësor dhe zbutja e ndryshimeve klimatike nga ndikimet negative gjatë kryerjes së aktiviteteve energjetike.

<sup>3</sup> <https://vlada.mk/node/29929>

<sup>4</sup> Закон за енергетика, „Службен весник на РМ“ бр. 96/18 и „Службен весник на РСМ“ бр. 96/19 и 236/22), член 2

Me Ligjin për Efikasitet Energjetikë transpozohen dispozitat e Direktivës 2012/27/EU për efikasitet energjetikë dhe Direktiva 2010/31/EC për karakteristikat energjetike të ndërtesave, të miratuar dhe ndryshuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetikë. Sipas ligjit, efikasiteti energjetikë është raporti ndërmjet efektit të dobishëm të arritur dhe inputit të energjisë për të arritur atë efekt të dobishëm. Ndër qëllimet e ligjit janë: zvogëlimi i nevojave për energji përmes shfrytëzimit efikas të energjisë duke zbatuar masa për efikasitet energjetikë dhe arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm të energjetikës përmes:

- › reduktimit të konsumit të energjisë duke aplikuar masa për efikasitetin energjetik dhe reduktimin e ndikimit negativ në mjedis jetësor dhe efikasitetin në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë;
- › rritjes së efikasitetit energjetikë duke përdorur burime të ripërtëritshme të energjisë<sup>5</sup>.

Qëllimet e efikasitetit energjetikë përcaktohen me Dekret të cilin e sjell Qeveria e RMV-së, me propozim të ministrisë<sup>6</sup>.

## PRIORITETET STRATEGJIKE TË QEVERISË DHE PROGRAMI I PUNËS SË QEVERISË SË RMV-SË 2020-2024

Ndër prioritetet strategjike të Qeverisë së RMV-së janë mbrojtja e mjedisit jetësor, zhvillimi i gjelbër, reduktimi i ndotjes së ajrit dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike.<sup>7</sup>

Në Programin e punës së qeverisë për periudhën 2020-2024, është caktuar një seksion i veçantë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e gjelbër. Sipas Programit, e drejta për një mjedis të shëndetshëm është një e drejtë themelore qytetare dhe kriza shëndetësore dhe ekonomike nuk duhet të nënkuptojë shtyrjen e politikave mjedisore. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vendosur të ndjekë strategjinë dhe planin e ri për rinovimin e komponentit ekonomik,

<sup>5</sup> Закон за енергетска ефикасност, („Службен весник на РСМ“ бр. 32/20, 110/21 и 236/22), чен 1,2 и 3

<sup>6</sup> ЗЕЕ, член 5

<sup>7</sup> <https://vlada.mk/strateshki-prioriteti?ln=mk>

social dhe mjedisor të BE-së në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe humbjes së biodiversitetit, veçanërisht përmes zbatimit të Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Në seksionin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, energjia veçohet me vendosmërinë për të forcuar pavarësinë energjetike, rritjen e prodhimit vendas, gjë që do të plotësojë nevojat e brendshme për energji shumë më tepër se më parë dhe deri në vitin 2024 mbi 50% e totalit të energjisë elektrike të instaluar në vend do të jetë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Në të njëjtën kohë, plani është që të reduktohen emetimet e gazrave të dëmshme nga burimet e energjisë me mbi 20%.

Gjatë gjashtë (6) muajve të parë, sipas Programit, duhet të bëhet prokurimi publik për modernizimin dhe transformimin e TEC Negotinë, në një termocentral që do të përdorë gazin natyror dhe do të ofrojë mundësi për rritjen e prodhimit bujqësor. Pas tenderit të shpallur për ndërtimin e HEC Çebren me partneritet publik-privat, është regjistruar interesim i shtuar dhe pritjet fillimi i ndërtimit të këtij projekti. Me centralet e reja fotovoltaike 400 MW, në sistemin elektroenergjetik vendas, është planifikuar të prodhohet energji elektrike e pastër në nivelin rreth 560 GWh (ose rreth 10% e totalit të prodhimit vendas), e cila do të reduktojë çlirimin e CO<sub>2</sub> në mjedisin jetësor me rreth 750.000 ton në vit, si dhe investimi total i pritshëm do të jetë rreth 250 milionë euro. Qeveria do të inkurajojë 46 inovacione në teknologjinë fotovoltaike.

Në kuadër të SHA ESM është planifikuar realizimi i këtyre projekteve: 1) Rivitalizimi dhe modernizimi i të tri njësive në REK Manastir, me reduktim të pluhurit dhe desulfurizimin; 2) Rivitalizimi dhe modernizimi i Bllokut 1 në REK Manastir për të reduktuar emetimet e oksideve të azotit dhe për të hapur mundësinë e përdorimit të llojeve të ndryshme të karburanteve; 3) Modernizimi dhe rehabilitimi i kullave ftohëse në REK Manastir, me qëllim të rritjes së efikasitetit të tyre dhe zëvendësimit të materialeve nga asbesti-çimentoja me materiale të pranueshme për mjedisin jetësor; 4) Blerja e makinerive ndihmëse për minierat në REK Manastir dhe pajisje për sistemin e shfrytëzimit të ndërprerë; 5) Përgatitjet për hapjen e minierës së Zhivojnos; 6) Rivitalizimi i hidrocentraleve të mëdhenj ekzistues.

Është planifikuar rikonstruksion i plotë i rrjetit të energjisë elektrike dhe ndërtimi i linjave të reja të transmetimit, të cilat do ta bëjnë MEPSO-në qendër rajonale të transmetimit të energjisë elektrike. Është planifikuar zbatimi i disa projekteve të linjave të energjisë elektrike. Ka filluar realizimi i gazsjellësit ndërlidhës me Greqinë dhe planifikohet të finalizohet ndërtimi i gazsjellësit kryesor Shkup-Tetovë-Gostivar me zgjerim të mëtejshëm deri në Kërçovë. Përmes SHA ESM është planifikuar ndërtimi i sistemit të ngrohjes për Manastirin, Mogillën dhe Novacin për objektet publike në qytet, i cili do të reduktojë ndjeshëm ndotjen, kurse përdoruesit do të kenë një mënyrë të pastër dhe të lirë të ngrohjes,

si dhe zgjerimin të furnizimit me energji termike të më shumë vendbanimeve të Shkupit me zgjerimin e rrjetit të ujit të ngrohtë. Përmes SHA ESM, në periudhën 2022-2024 është planifikuar ndërtimi i një centrali të ri kogjenerues prej 50 MW në kuadër të objektit ekzistues ENERGETIKA në Zhelezarë, i cili do të mundësojë prodhim shtesë të energjisë elektrike dhe do të plotësojë nevojat për energji termike në një çmim më të lirë.<sup>8</sup>

# STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E ENERGETIKËS NË RMV DERI NË VITIN 2040 DHE PLANI NACIONAL PËR ENERGINË DHE KLIMËN E RMV

Tendencat e energjetike theksojnë tranzicionin më ambicioz drejt një ekonomie me karbon të ulët, me burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe efikasitetin e energjetik (EE) që janë ndër faktorët më të rëndësishëm që mundësojnë tranzicionin. Tendencat globale energjetike sjellin në plan të parë ndryshimin e klimës dhe mungesën e burimeve. Paralelisht me rritjen e nevojave globale për energji të përbalueshme dhe të besueshme, bota po shkon drejt përdorimit më të madh të energjisë me karbon të ulët. Me kërkesat e ligjit të ri për energjetikë, në dhjetor 2019 u miratua Strategjia për zhvillimin e energjetikës në RMV<sup>9</sup> deri në vitin 2040, i cili zbatohet nga Qeveria e RMV-së. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Energjetikës, është përgatitur Programi për Zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Energjetikës 2021-2025<sup>10</sup> (më tej Programi).

Vizioni i Strategjisë së Zhvillimit të Energjetikës është sistem energjetik i besueshëm, efikas, ekologjik dhe konkurrues, i aftë për të stimuluar një rritje të qëndrueshme ekonomike, i cili parashikon një ulje të konsumit të energjisë me 27%, ndërsa në të njëjtën kohë rritje të PBB-së dhe **rritje të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë nga 18% në 45%** deri në vitin 2040. Kjo do të lejonte që varësia nga importi të mos rritet në krahasim me nivelin e vitit 2019.

Me Planin Nacional të Energjisë dhe Klimës të RMV-së<sup>11</sup> shpjegohen të ashtuquajturat pesë dimensionet e Unionit Energjetik, gjegjësisht dekarbonizimi (që mbulon dy segmente: emetimet e gazeve serrë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë), efikasitetin e energjetik, sigurinë e furnizimit me energji, tregun e brendshëm të energjisë, si dhe hulumtimin, inovacionin dhe konkurrencën.

<sup>8</sup> [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/programa-na-vlada-agenda2024-finalno\\_programa\\_1.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/programa-na-vlada-agenda2024-finalno_programa_1.pdf)

<sup>9</sup> [https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Energy%20Development%20Strategy\\_FINAL%20DRAFT%20-%20For%20public%20consultations\\_MK\\_29.10.2019\(4\).pdf](https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Energy%20Development%20Strategy_FINAL%20DRAFT%20-%20For%20public%20consultations_MK_29.10.2019(4).pdf), Службен весник на РСМ 25/20

<sup>10</sup> [https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Program%20for%20the%20realization%20of%20the%20strategy%20Final%20version%20for%20public%20consultation%2030juli%202021%20MK\(1\).pdf](https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Program%20for%20the%20realization%20of%20the%20strategy%20Final%20version%20for%20public%20consultation%2030juli%202021%20MK(1).pdf)

<sup>11</sup> <https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Official%20NECP%20Draft%20-%20MK%20version-for%20public%20consultation%2015%20July%202021.pdf>

Dimensioni i dekarbonizimit parashikon zbatimin e të gjitha aktiviteteve të identifikuara për të zbutur ndryshimet klimatike që do të reduktojnë më tej emetimet e gazeve serrë, duke rritur në të njëjtën kohë në mënyrë të qëndrueshme pjesën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në konsumin bruto përfundimtar të energjisë. Një objektiv kyç është kalimi i sektorit të energjisë drejt teknologjive me karbon të ulët, i cili përfshin një plan për të hequr gradualisht termocentralet me qymyr dhe për të përshpejtuar përdorimin e burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë elektrike të kombinuar me masat e efikasitetit energjetik në të gjithë sektorët.

Në kuadër të dimensionit të efikasitetit energjetik, shteti do të përpiqet të rrisë kursimet në konsumin e energjisë primare dhe finale, prandaj Maqedonia e Veriut planifikon të zbatojë një numër të madh politikash dhe masash në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2040, me qëllim të reduktimit të konsumit të energjisë në ndërtesa (amvisëri, ndërtesa tregtare dhe publike), sektori i industrisë, sektori i transportit dhe për të reduktuar humbjet gjatë transformimit të energjisë dhe në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Për sa i përket sigurisë energjetike, ne synojmë të reduktojmë importet e energjisë duke përdorur më shumë burime të ripërtëritshme të energjisë dhe duke rritur efikasitetin energjetik, ndërsa në të njëjtën kohë planifikojmë të diversifikojmë burimet tona të furnizimit përmes përdorimit të gazit natyror (në sektorin e industrisë). Sipas situatës aktuale, janë identifikuar rreziqe të mundshme për sigurinë e furnizimit, të cilat përfshijnë përdorimin e kufizuar të burimeve vendase në prodhimin e energjisë (kryesisht të bazuar në linjit, biomasë dhe hidrocentrale), varfërimin e burimeve të qymyrit, ekzistencën e vetëm një ndërlidhje për furnizimin me gaz natyror dhe varësia e madhe nga importet e energjisë (me gati 60% të konsumit total të energjisë primare).

Sipas Planit Kombëtar, ekziston një skenar-WAM me masa shtesë dhe një skenar-WEM me masa ekzistuese për realizimin e planit. Një nga faktorët më të mëdhenj që ndikon në realizimin, jo vetëm të skenarit WAM, por edhe të skenarit WEM, është se hidrocentrali Çebren dhe hidrocentral e të tjera të mëdha të planifikuara nuk janë ndërtuar, të cilat përmirësojnë ndjeshëm fleksibilitetin e sistemit dhe lejojnë përfshirje më të madhe të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) të ndryshme në sistem. Gjithashtu, në kushtet e reduktimit të prodhimit apo mbylljes së TEC Manastirit, kjo masë është kyçe për rritjen e sigurisë së furnizimit dhe gjithashtu kontribuon në rritjen e pjesëmarrjes së BRE-së.

Sipas analizave të ndjeshmërisë, nëse nuk ndërtohen HEC-et Çebren dhe të tjerë, duhet të mendohet për ndërtimin e një elektro-centrali (EC) me gaz. Kjo do të rrisë fleksibilitetin e sistemit, por në krahasim me opsionin e HEC-eve nuk do të kontribuojë aq shumë në përmirësimin e pjesës së përgjithshme të BRE-ve dhe uljen e varësisë nga importi. Ndërtimi i një EC-je të re me gaz kushtëzohet nga ndërtimi i një ndërlidhjeje të re të gazit. Opsioni i fundit, më i pafavorshëm është rritja e importit të energjisë elektrike.<sup>12</sup> Për të rritur ruajtjen e energjisë dhe fleksibilitetin e sistemit, ndër prioritetet kryesore është ndërtimi i hidrocentralit Çebren. Synimi është vënia në punë e këtij hidrocentrali deri në vitin 2028.<sup>13</sup>

<sup>12</sup> <https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Official%20NECP%20Draft%20-%20MK%20version-for%20public%20consultation%2015%20July%202021.pdf>, страна 180

<sup>13</sup> <https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Official%20NECP%20Draft%20-%20MK%20version-for%20public%20consultation%2015%20July%202021.pdf>, страна 71

# PROGRAMI PËR ZBATIM TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË ENERGJETIKËS 2021-2025

Në Programin për zbatim të strategjisë së zhvillimit të energjetikës, mund të gjenen më shumë se 80 politika dhe masa, që pasqyrojnë pesë dimensionet e Unionit të Energjisë. Masat ndahen në shtylla dhe përveç kësaj, brenda vetë shtyllave ka një ndarje sipas sektorëve apo lëndëve djegëse. Periudha kohore e realizimit është nga viti 2021-2025. Në kuadër të politikave dhe masave janë shtyllat: 1. Efikasitetit energjetikë, e cila përfshinë: ekonomitë familjare, sektorin tregtar dhe industrinë; 2. Integrimi dhe siguria e tregut të energjisë elektrike, që përfshin energjinë elektrike, gazin natyror dhe naftën dhe produktet e naftës; 3. Dekarbonizimi; 4. Hulumentimi, inovacioni dhe konkurrenca dhe 5. Aspektet ligjore dhe rregullatore.

Për zbatimin e politikave dhe masave janë përgjegjëse disa subjekte: Qeveria e RMV-së, Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vetëqeverisja lokale, më tej donatorë dhe institucione financiare, kompani private dhe të tjera, në varësi të shtyllave dhe sektorëve. Çdo politikë dhe/ose masë, përveç kornizës kohore, ka një objektiv dhe përshkrim kryesor, dokumentet përkatëse të planifikimit, aktet ligjore dhe rregullatore, supozimet, statusin e zbatimit (hapat e ndërmarrë dhe të parashikuar), treguesit, subjektin kompetent, subjektin monitorues, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, si dhe rreziqet. Shtylla e dekarbonizimit përfshinë: ndërtimin e Çebrenit, ndërtimin e Luginës së Vardarit, ndërtimin e një centrali të ri me gaz, ndërtimin e centralit fotovoltaik 120 MW, ndërtimin e centralit fotovoltaik 160 MW në Manastir, ndërtimin e centralit fotovoltaik 100 MW në Tikvesh, ndërtimi i një centrali fotovoltaik 25 MW në lokacionet në pronësi të ESM-së, ndërtimi i parkut me erë 50 MW Miravci dhe parkut 80 MW Koprishnica dhe Petrovë, mbështetje me tarifë preferenciale, termocentrale me biomasë (me mundësi për TE-TO), mbështetje me premi dhe centrale diellore në çati. Qëllimi kryesor i të gjitha politikave dhe masave është rritja e kapaciteteve prodhuese vendase nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Për ndërtimin e Çebrenit, u morën parasysh ndikimet mjedisore dhe sociale. Qëllimi kryesor i këtij projekti është sigurimi i fleksibilitetit të sistemit, i cili do të rrisë përdorimin më të madh të BRE-ve për prodhimin e energjisë elektrike dhe nga ana tjetër, të sigurojë besueshmëri më të madhe të sistemit dhe tregut të energjisë elektrike. Në rubrikën për statusin e zbatimit, nga hapat e fundit të ndërmarrë, thuhet se tenderi i parakualifikimit për Çebrenin ka përfunduar. Ndërtimi pritet të fillojë në vitin 2024, ndërsa procedura e prokurimit publik duhet të shpallet dhe të përfundojë në fund të vitit 2022.

Sipas një analize të detajuar të prodhimit të energjisë elektrike në bazë ore, rezulton se roli i Çebrenit është më se domethënës për sigurimin e besueshmërisë së sistemit të energjisë elektrike dhe duke qenë se ndërtimi i tij pritet të zgjasë 7 vjet, është e nevojshme të fillojë zbatimi sa më shpejt që të jetë e mundur për të mundësuar realizimin e skenarit të Gjellbër.<sup>14</sup>

Ky program, i cili është përgatitur në mars të vitit 2021, i referohet periudhës 2021-2025, proceset për disa nga masat kanë filluar, por ende në vitin 2023 nuk është miratuar nga Qeveria e RMV-së.

<sup>14</sup> [https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Program%20for%20the%20realization%20of%20the%20strategy%20Final%20version%20for%20public%20consultation%2030jul%202021%20MK\(1\).pdf](https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Program%20for%20the%20realization%20of%20the%20strategy%20Final%20version%20for%20public%20consultation%2030jul%202021%20MK(1).pdf), crp.183 v184

# PLANI PËR TEJKALIMIN E KRIZËS ENERGETIKE TË QEVERISË SË RMV-SË

Sipas Qeverisë së RMV-së dhe planit të prodhimit të ESM-së, kompania shtetërore e prodhimit të energjisë elektrike do të rritet me 25% në vitin 2022, puna e së cilës do të monitorohet çdo ditë nga zbatimi i detyrave që i janë dhënë ESM-së dhe atë: fillimi i funksionimit të bllokut të tretë në REK Manastir, fillimi i operimit të bojlerit të dytë në rezervën TEC Negotinë, operimi i hidrocentraleve dhe më e rëndësishmja, përdorimi i të gjithë potencialit dhe vënia në punë e centralit të gazit të kogjenerimit TE-TO në Shkup gjatë dhe pas sezonit të ngrohjes, si dhe përdorimi i të gjitha burimeve të ripërtëritshme të energjisë - dielli, era dhe uji.

Një nga qëllimet e Qeverisë është që të marrë përsipër funksionimin e BEG-ut dhe objekteve të tjera që nevojiten për sigurimin e energjisë termike nga ESM-ja, duke pasur parasysh se BEG-u nuk ka pasur mundësi të kryejë shërbimet e veta në këto kushte dhe qyteti i Shkupit ka refuzuar të marrë përsipër këtë shërbim komunal që është në kompetencën e tij. ESM-ja, pas përfundimit të të gjitha procedurave, do të marrë përsipër furnizimin me energji termike për 55.000 amvisëri në qytetin e Shkupit.

Deri në muajin shtator 2022 janë ndërmarrë këto aktivitete, të cilat u janë dhënë si detyrë dhe obligim ndërmarrjeve, ministrive dhe institucioneve përkatëse në sektorin e energjisë:

- › Sigurimi i thëngjillit të nevojshëm për prodhimin e energjisë elektrike në REK Manastir dhe Oslomej;
- › Sigurimi i lëndës djegëse të nevojshme mazutit për prodhimin e energjisë elektrike në TEC Negotinë dhe për procesin e prodhimit në REK Manastir dhe Oslomej;
- › Sigurimi i gazit të nevojshëm për prodhimin e energjisë elektrike në TE-TO dhe në centralin Kogel në pronësi të ESM-së.<sup>15</sup>

<sup>15</sup> <https://vlada.mk/node/30081>

# KONKLUZIONE

Sipas Programit të Punës së Qeverisë dhe Planit Nacional, parashikohet një varësi më e vogël e shtetit nga importi i energjisë, por sipas të dhënave të Entit Shtetëror Statistikor në vitin 2021, prodhimi i përgjithshëm bruto i energjisë primare në Republikën e Maqedonisë së Veriut ishte 32.6% e totalit të energjisë së nevojshme, që është pothuajse 6% më pak se në vitin 2020, kur prodhimi i përgjithshëm bruto i energjisë primare në Republikën e Maqedonisë së Veriut ishte 38,3% e totalit të energjisë së nevojshme, ose 7,8% më pak se në vitin 2019, kur ishte 40,4% e totalit të energjisë së nevojshme.<sup>16</sup>

Nëse merren parasysh vendimet dhe planet e qeverisë nga fundi i vitit 2021 dhe gjatë vitit 2022, lind pyetja nëse shteti po përpiqet realisht të zvogëlojë varësinë nga importi i energjisë duke përdorur më shumë burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe duke mundësuar efikasitetin energjetikë. A është ajo që po bëhet në drejtim të dekarbonizimit dhe kalimit në një ekonomi me karbon të ulët me përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë? Edhe pse në tregun global ka pasur ndryshime në sektorin e energjisë, si pasojë e zhvillimeve globale, kjo nuk duhet të jetë një arsye për të mos mundur të zbatohet ajo që është ndërmarrë dhe planifikuar ose për të devijuar për shkak të krizës në zhvillim, e cila nuk varet vetëm nga faktorët e gjendjes së brendshme në shtet. Plani i Qeverisë për tejkalimin e krizës energjetike devijon dukshëm nga qëllimet, masat dhe planet e parashikuara me rregullore dhe akte të tjera. Sipas Programit të Punës së Qeverisë, kriza shëndetësore dhe ekonomike nuk duhet të nënkuptojë shtyrjen e politikave mjedisore. Gjithashtu mund të konkludohet se nuk ka kontroll dhe/ose monitorim të zbatimit të asaj që është planifikuar dhe të përcaktuara në mënyrë strategjike.

Gjatë ndërmarrjes së detyrimeve për zbatimin e skenarit të dekarbonizimit, shteti, krahas rreziqeve që ekzistojnë për zbatimin e politikave dhe masave, kishte detyrimin të merrte parasysh edhe mundësinë e një krize të shkaktuar nga faktorë të jashtëm jashtë sektorit. Obligimet e marra dhe qëllimet e vendosura nuk guxojnë të shtyhen, por realizimi i tyre duhet të përshtatet përmes prioritizimit dhe gjetjes së mënyrave dhe mekanizmave për realizimin e të planifikuarve. E përbashkëta për të gjithë dokumentet e cituara është se një nga synimet prioritare është ndërtimi i HEC Çebrenit, por deri në janar 2023, nuk është përzgjedhur asnjë kompani për zbatimin e këtij partneriteti publiko-privat.

<sup>16</sup> <https://www.stat.gov.mk/>

